



**KCDE - Mëso Online**  
Kosovo Center for Distance Education



**ICEDA**

Increasing Civic Engagement  
in the Digital Agenda

e-learning  
laws

Janar  
2022

#digital

#regulations

#policy

# POLITIKAT (E MUNGUARA) PËR QEVERISJE TË E-MËSIMIT NË KOSOVË



The project is co-funded by  
the European Union



The "Increasing Civic Engagement in the Digital Agenda - ICEDA" project is implemented by Metamorphosis Foundation (North Macedonia), Open Data Kosovo (Kosovo), e-Government Academy (Estonia), Partners for Democratic Change Serbia (Serbia), NGO 35 MM (Montenegro) and Lëvizja MJAF (Albania).

## DEKLARATË MOHIMI

Ky hulumtim është përgatitur si pjesë e projektit "Rritja e Pjesëmarrjes së Qytetarëve në Agjendën Digjitale - ICEDA" me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Përmbajtja është përgjegjësi e Kosova Center for Distance Education (KCDE) - Mëso Online, dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

### Informata mbi Autorët

Antigona Uka  
Drejtoreshë Ekzekutive, KCDE  
antigona.uka@kcde-ks.org

### Informata mbi Editorët

Aaron Spitler  
Hulumtues, KCDE  
aaron.spitler@kcde-ks.org

Origjinali është shkruar në gjuhën Angleze në kuader të projektit:

"Avokimi për integrimin digjital në sistemin arsimor: Forcimi i arsimit në distancë në Kosovë"

Implementuar nga:



**KCDE - Mëso Online**  
Kosova Center for Distance Education

Kosova Center for Distance Education-Mëso Online

[www.mesoonline-ks.org](http://www.mesoonline-ks.org)

E drejta autoriale © 2020 nga KCDE - MESO ONLINE. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem riprodhimi apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik apo mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi.

# Punim Udhëzues

Edhe pse mësimi online (e-learning) zuri titujt kryesor të mediave kohëve të fundit, përpjekjet për të ofruar një strategji rreth kësaj forme të mësimit në Kosovë ka qenë e pranishme për mëse një dekadë. Megjithatë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka shtuar përpjekjet e saj si përgjigje ndaj situatës së krijuar nga pandemia. Mirëpo, masat e ndërmarra deri tash kanë dështuar të sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë nxënësit në procesin mësimor.

Në draft Strategjin për e-mësim të vitit 2010-2015, ishte dhënë fokus në ndërtimin e infrastrukturës dhe në identifikimin e lëndëve/klasëve që mund të përfitonin nga mësimi online (e-learning). Palët e interesit kishin kuptuar që strategjia e re kombëtare për e-mësimin do t'i shtronte rrugë fillimit të sektorit të mësimit në distancë. Edhe pse deri atëherë pa strategji të mirëfilltë, vet njohja e rëndësisë së mësimit online ishte një hap pozitiv. Profesionistët dhe përfaqësuesit tjerë të ekipit punues kishin theksuar se krijimi i një kornize ligjore do të garantonte integrimin e mësimit online në nivele të ndryshme të arsimit në vendin tonë.

**(Draft) Strategjia e e-mësimit 2010-2015, parashihte “një edukim cilësor dhe konkurues, për një shoqëri të bazuar në dije, me një sistem të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të e-mësimit, i cili do të lehtësonte zhvillimin socio-ekonomik dhe do të rriste mundësitë e të mësuarit gjatë gjithë jetës (Lifelong Learning)”.**

Krijimi i një kornize të tillë ligjore do të ishte vendimtare në zgjerimin e disponueshmërisë së e-mësimit, si dhe në inkurajimin e mësimeve në mësimin online. Për më tepër, studime të ndryshme tregojnë se për nxënësit të cilët kanë qasje në teknologji, të mësuarit online (digjital) mund të jetë më efektiv sesa thjeshtë të mësuarit tradicional. Kjo u mundëson atyre të "mësojnë me ritmin e tyre duke lexuar, rilexuar ose duke kaluar kohë me konceptet që ata dëshirojnë". Shikuar nga perspektiva e politikëbërjes është e qartë se sigurimi i përfshirjes digjitale është po aq i rëndësishëm sa ndërtimi i aftësive praktike kur bëhet fjalë për zgjerimin e mundësive përmes "mësimin online".

Të vetmet dokumente politikbërëse janë manualet/udhëzimet të cilat janë miratuar nga MASHTI për përdorim në shkollat që kanë qenë të detyruara të përshtaten me pandeminë. Njëherit, paralelisht është ngritur një grup punues për hartim të Strategjisë Shtetërore të Digjitalizimit të Arsimit.

Shikuar në kontekstin aktual, grupi punues i sapoformuar ka për qëllim të ndikojë në ndryshimin e politikave në këtë sektor. Megjithatë:

- 1. A i kemi ne (Kosova) kapacitetet për t'i bërë realitet këto reforma?**
- 2. A kemi ofertues të përshtatshëm që mund t'i akomodojnë kërkesat për regjistrim online?**
- 3. Më e rëndësishmja, a janë mësimitdhënësit e klasëve dhe administratorët e shkollave të gatshëm për të përqafuar integrimin e teknologjisë në arsim formal?**

Një mënyrë për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve është të fillojmë t'i njoftojmë mësimitdhënësit me mësimin online. Nëse arrijmë t'i bindim këta të fundit se mund të mësojnë në këtë formë, atëherë nuk është e vështirë për ta që të besojnë se nxënësit mund të kenë sukses në mësim online.

Pra, ata të cilët besojnë se mënyra e vetme për të mësuar është në mes katër mureve të shkollës janë mësimitdhënësit, e jo nxënësit apo prindërit. Por nëse arrijmë ta ndryshojmë këtë bindje për ta personalisht ndoshta mund të kemi ndryshime pozitive. Në momentin që kemi personel të gatshëm për të eksploruar mundësitë e ofruara nëpërmjet e-mësimit, atëherë do mundësoj që kjo formë e mësimitdhënies të institucionalizohet.

Duke u bazuar në një të ardhme "pas-COVID", mësimi online apo e-mësimi në Kosovë kërkon investime të konsiderueshme në infrastrukturë ligjore dhe teknologji. Për më tepër kërkon edhe krijimin e përmbajtjes digjitale si dhe përshtatjen e kurrikulave për të mundësuar përdorimin e teknologjisë në arsim. Përfundimisht e gjithë kjo varet nga një mbështetje e gjerë e komunitetit në vend. Kosova Center for Distance Education (KCDE), është duke krijuar një rrjetë bashkëpunimi me politikbërësit për të fuqizuar zbatimin e e-mësimit, duke ndarë ekspertizën me ta për të siguruar që zgjidhjet e ofruara adresojnë nevojat e të gjithë nxënësve.

Tutje, KCDE është në proces të themelimit të një komiteti për e-mësim, i cili do të identifikojë hapat që duhet të ndërmarrim në ngritjen e këtij sektori. Për më shumë, komiteti i e-mësimit do të shërbejë si një mekanizëm mbikëqyrës dhe monitorues për zbatimin e Strategjisë Shtetërore të Digjitalizimit të Arsimit.

Përderisa pandemia ka ngjallur interes për këtë temë, politikëbërësit duhet ta shfrytëzojnë këtë mundësi për t'u angazhuar me palët e interesuara në të gjithë sektorin e arsimit. Në rast të hartimit dhe miratimit të politikave dhe dokumenteve qeverisëse në lidhje me mësimin elektronik: administratorët e shkollave, mësimdhënësit, këshilltarët, mentorët, prindërit dhe nxënësit në Kosovë, kanë nevojë për përfaqësim dhe informacione të sakta rreth ndryshimeve në politikën arsimore të cilat u mundësojnë nxënësve tanë të ndjekin kurse online.





The project is co-funded by the European Union

The "Increasing Civic Engagement in the Digital Agenda – ICEDA" project is implemented by Metamorphosis Foundation (North Macedonia), Open Data Kosovo (Kosovo), e-Government Academy (Estonia), Partners for Democratic Change Serbia (Serbia), NGO 35 MM (Montenegro) and Lëvizja MJAFT (Albania).